# DËSHMI ARKIVI

**A-468834**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pas debatit në Tiktok, 23 të mitur lënë takim për sherr në Yzberisht |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394084.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 12:39:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 12:25:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 12:24:00 UTC → 25 shtator 2026, 12:26:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c3cfbd7f57cb0d123018810f5dea41dbc9b0f190cf607685877d9e83ac8d682a` |
| TEKSTI | `b95ac9e6c6c092a85c404be0e4de6cff84982081572f43f33fd73078020dd152` |
| PAMJA | `cc21f6a86b013866d49a9062741da573755f8398af83cdc336ec2ef0f7434650` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `09eff384c2cffc94dea14a9f8b4bde92799b12757f2f83088e8a2db01a0a6889` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7ef11613d0a46fe814f564609ee7439753917635a3984a70b661e478103337ad` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/09eff384c2cffc94dea14a9f8b4bde92799b12757f2f83088e8a2db01a0a6889`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pas debatit në Tiktok, 23 të mitur lënë takim për sherr në Yzberisht

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 25.09.2026, 14:25

Share Share



Një sherr që nisi në TikTok rrezikoi të kthehej në përplasje mes 23 të miturve, nga 13 deri në 17 vjeç, në Yzberisht. Debati fillimisht kishte nisur mes dy të rinjve në rrjetet sociale, por më pas secili kishte mbledhur shokët e vet dhe dy grupet nisën të sfidonin njëri-tjetrin. Nga mesazhet online, ku shkëmbeheshin provokime dhe “sfida” për të treguar se kush ishte më i forti në lagje, të rinjtë kishin lënë takim në rrugën “Besim Alla” për t'u përballur.

Por “sqarimi” nuk do të bëhej vetëm me fjalë. Disa prej të miturve kishin marrë me vete shkopinj bejsbolli, ndërsa në momentin e ndërhyrjes u sekuestruan dy të tillë. Të rinjtë u shoqëruan dhe u identifikuan të gjithë pjesëtarët e grupeve, ndërsa në prani të prindërve dhe psikologut nisi procedimi në gjendje të lirë për 23 të mitur.

Ngjarja tregon edhe një herë se sa shpejt një debat banal në rrjetet sociale mund të kalojë nga ekrani në rrugë. Një koment, një video apo një provokim në TikTok mjaftoi që dy grupe adoleshentësh të caktonin vendin e takimit dhe të përgatiteshin për përplasje. Nga “kush është më i forti në TikTok” te shkopinjtë e bejsbollit ishte vetëm një hap.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

## Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.